

A DO TË JENË OBJEKT I HETIMIT EDHE KANDIDATËT PËR DEPUTET QË U KANË SHTUAR VOTAT?

FAQE 4-5

Ulje-ngritjet e konsiderueshme të partive politike në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit në Kosovë ranë shpejt në hije, kur nisi të zbu-

lohej ajo që duket se është shkallë e gjerë e manipulimit me vota të kandidatëve për deputetë. Nga të gjitha partitë, në disa qytete, Koordinatorja për zgjedhje, Laura Pula, ka

bërë me dije se në hetime do të përfshihen edhe kandidatët që u janë shtuar vota. Një gjë të tillë e kanë kërkuar edhe organizatat që merren me proceset zgjedhore në vend

SHBA-ja DHE BE-ja SHPREHIN SHQETËSIM PËR MOSMIRATIMIN E PËRBËRJES SË LISTËS SERBE NGA KQZ-ja

F. 3



KOSOVA, SHOIPËRIA DHE KROACIA THELLOJNË BASHKËPUNIMIN TREPALËSH NË FUSHËN E MBROJTJES

F. 5

AKTUALE

POLICIA SËRISH GJEN ARMË NË VERI, MUNICION DHE MJETE TË TJERA ILEGALE

F. 5

DËNOHET ME 12 VJET E 6 MUAJ BURGIM SËRGJAN LAZOVIQ PËR KRIME LUFTË

F. 6

“LIRIA KA EMËR” MERR MBËSHTETJE EDHE NGA SUHAREKA PËR MARSHIN “DREJTËSI, JO POLITIKË” MË 17 SHKURT

F. 7

EKONOMI

FERRONIKELI PAS DY DEKADASH PRIVATIZIM: 80 PUNËTORË, ZERO PRODHIM

F. 8

SPORT

UEFA I PËRGJIGJET MINISTRI ÇEKU: ÇDO KOMUNIKIM ZYRTAR KALON VETËM PËRMES FFK-së

F. 11

RENOVA

PUTZ

Maqedoni

Xhepçisht –Tetovë

Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009

+389 44 487 755

Fax: +389 44 487 200

Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177

www.princesha-ks.com

Bunjamini

FABRIKA E LLAQEVE

STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

044/256-051

044/367-061

028/532-617

MITROVICË

Kolegji BIZNESI

www.kolegji.biznesi.com

info@kolegji.biznesi.com

030 500 878 | 045 500 878

044 500 878 | 049 500 878

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY

Digital Agency

Endrit Shaqiri

+38344685122

Internet Website,
Marketing...

HEGSETH: SHBA-ja, E PËRGATITUR TË NDËRMARRË VEPRIME KUNDËR IRANIT

PRISHTINË, 3 SHKURT - Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Pete Hegseth, sërish ka paralajmëruar Teheranin se Pentagoni është “më se i përgatitur” për të ndërmarrë veprime nëse Irani refuzon të negociojë për programin e tij bërthamor. “Presidenti [amerikan, Donald Trump] ka qenë shumë i qartë që nga fillimi, edhe para [v.j. operacionit ushtarak amerikan kundër objekteve bërthamore të Iranit në qershor 2025] Çekanit të Mesnatës. Irani nuk do të ketë kapacitete për armë bërthamore. Pra, ata mund të negociojnë në këtë drejtim ose ne kemi opsione të tjera”, tha Hegseth më 2 shkurt për gazetarët gjatë një udhëtimi

për në Floridë. Duke theksuar se veprimi ushtarak nuk është opsioni i preferuar, Hegseth shtoi se “[presidenti Trump] nuk dëshiron të shkojë kësaj rruge, unë nuk dua të shkoj kësaj rruge, por është detyra jonë që të jemi të përgatitur, prandaj edhe jemi të përgatitur, jemi më se të përgatitur”. Ai, po ashtu, tha se Irani “ka një zgjedhje” për të negociuar. Duke folur për gazetarët në Shtëpinë e Bardhë një ditë më parë, presidenti Trump tha se Irani po “bisedon seriozisht” me Shtetet e Bashkuara. Udhëheqësi amerikan shtoi se Uashingtoni po mban presionin ndaj Teheranit. “Ne kemi anije që janë duke shkuar



drejt Iranit tani, anije të mëdha... dhe ne po zhvillojmë bisedime me Iranin. Të shohim se cili do të jetë rezultati”, tha ai. Ushtria amerikane ka dislokuar në afërsi të brigjeve

të Iranit një grup sulmues detar, të udhëhequr nga aeroplanmbajtësi USS Abraham Lincoln. Presidenti Trump nuk e ka përjashtuar mundësinë e një veprimi ushtarak ndaj Iranit si

kundërpërgjigje ndaj shtypjes brutale të protestave antiqeveritare që shpërthyen në fund të dhjetorit në mbarë Iranin. Organizata për të drejtat e njeriut me seli në ShBA, HRANA, shifrat e të cilave Radio Evropa e Lirë i ka cituar vazhdimisht që nga nisja e shtypjes së dhunshme në Iran, thotë se numri i vdekjeve të konfirmuara, përfshirë edhe të forcave të sigurisë, tani është 6 563, ndërkaq numri i vdekjeve që ende po hetohen është 17 091. Më shumë se 49 000 persona janë arrestuar. Disa medie, duke cituar zyrtarë të pidentifikuar, kanë raportuar se numri i viktimave është shumë më i lartë.

MUNGESA E PUNËTORËVE TË KUALIFIKUAR NË GJERMANI

BERLIN, 3 SHKURT - Gjermania po përballlet me një mungesë të madhe të punëtorëve të kualifikuar - nga infermierët te specialistët e IT-së. Por Gjermania ka probleme të mëdha, madje edhe politike. Në një klasë në Chennai të Indisë, rreth 20 infermierë po mësojnë gjermanisht me një shpejtësi të madhe. Ato kanë gjashtë muaj për të mësuar gjuhën në mënyrë që të mund të punojnë në Gjermani. Ramalakshi, një prej tyre, thotë se nuk ishte e lehtë për familjen e saj të paguante mijëra euro që ajo të përfundonte shkollimin në infermieri. Tani, ajo ndjen nevojën për t'i shlyer këto investime. “Qëllimi im është të punoj jashtë vendit. Dua të siguroj jetesën financiare për familjen time dhe të ndërtoj një



shtëpi për veten time”, tha ajo për DW. Qeveria e shtetit jugor indian të Tamil Nadu po financon kursin e gjuhës për të ulur papunësinë dhe për t'u dhënë familjeve në disavantazh një shans në tregun global të punës.

Agjencitë private më pas lidhin infermierët indianë me punëdhënësit potencialë. Gjermania po kërkon me dëshpërim punëtorë të kualifikuar, ndërsa e ashtuquajtura gjeneratë “baby boomer” del në pension në

vitet e ardhshme, ndërsa shumë pak fëmijë po lindin. Spitalet kanë mungesë infermierësh, shkollat kanë mungesë mësuesish dhe sektori i IT-së po kërkon programues. Ekonomistët në Institutin për Kërkime të Tregut të Punës (IAB) në Nuremberg vlerësojnë se Gjermania duhet të tërheqë 300 000 punëtorë të kualifikuar çdo vit vetëm për të ruajtur status quo-në. Pa ta gjermanët do të duhej të punonin më gjatë, të dilnin në pension më vonë - ose thjesht të ishin më të varfër, tha për DW studiuesi i IAB, Michael Oberfichter. Sipas shifrave të fundit nga Zyra Federale për Migracionindhe Refugjatët, rreth 160 000 të huaj me leje

qëndrimi janë të regjistruar si punëtorë të kualifikuar. Por zyra është gjithashtu përgjegjëse për përpunimin e kërkesave për azil të miliona refugjatëve që kanë mbërritur në Gjermani vitet e fundit për shkak të luftërave dhe konflikteve, si ato në Siri dhe Ukrainë. Për shkak të mungesës së digjitalizimit, burokracia gjermane është e ngadaltë. Rritja e ndjeshme e numrit të refugjatëve dhe dështimi i qeverisë për t'i integruar ata në tregun e punës çuan në pakënaqësi në rritje me politikat e migracionit dhe mbështetje në rritje për partinë e ekstremit të djathtë kundër emigrantëve, Alternativa për Gjermaninë (AfD).

PIKËKALIMI NË RAFAH NË GAZË RIHAPET NË MËNYRË TË KUFIZUAR PAS DY VJETËSH LUFTE

GAZA, 3 SHKURT - Pikëkalimi kyç kufitar në Rafah të Gazës u rihap për palestinezët, tha një zyrtar izraelit i sigurisë, por media egjiptiane e lidhur me shtetin raportoi se vetëm 50 persona do të lejohen të kalojnë në secilin drejtim në ditët e para. Rifillimi i operacioneve vjen pasi forcat izraelite morën kontrollin e kësaj porte hyrëse drejt Egjiptit në maj të vitit 2024, gjatë luftës me Hamasin, të shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja. Një rifillim i pjesshëm i operacioneve nisi të dielën, në një fazë shumë të kufizuar që nuk përfshinte lëvizjen e njerëzve, pas muajsh thirrjesh

nga grupet e ndihmës. “Që nga ky moment, dhe pas mbërritjes së ekipeve të EUBAM-it në emër të Bashkimit Evropian, pikëkalimi në Rafah është hapur tashmë për lëvizjen e banorëve, si për hyrje ashtu edhe për dalje”, tha zyrtari izraelit, duke iu referuar misionit evropian të asistencës kufitare. Media egjiptiane e lidhur me shtetin raportoi se pritej që 50 persona të kalonin në secilin drejtim në ditët e para të rihapjes. AlQahera News, e lidhur me inteligjencën shtetërore, raportoi duke cituar një burim të paemëruar se “pesëdhjetë persona do të largohen nga Egjipti drejt Gazës dhe pesëdhjetë persona do të vijnë



nga Gaza”, në ditët e para të operimit. Një burim në kufi i tha AFP-së

se disa dhjetëra persona mbërritën të hënë në anën egjiptiane duke pritur hyrjen në

Gazë. Megjithatë, transmetuesi shtetëror izraelit Kan raportoi se rreth 150 persona pritej të largoheshin nga Gaza drejt Egjiptit të hënë, përfshirë 50 pacientë. Raporti tha se rreth 50 të tjerë pritej gjithashtu të hynin në territor, duke shtuar se pikëkalimi do të ishte i hapur për rreth gjashtë orë në ditë. “Pikëkalimi i Rafahut është një vijë shpëtimi”, tha Mohammed Nassir, një palestinez të cilit iu amputua këmba pasi u plagos në fillim të luftës. “Kam nevojë t'i nënshtrohem një operacioni që nuk mund të kryhet në Gazë, por që mund të bëhet jashtë vendit”.

SHBA-JA DHE BE-JA SHPREHIN SHQETËSIM PËR MOSMIRATIMIN E PËRBËRJES SË LISTËS SERBE NGA KQZ-ja

PRISHTINË, 3 SHKURT - Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të mos miratuar listën e kandidatëve për deputetë të Listës Serbe është “në kundërshtim me të drejtën e qytetarëve për të zgjedhur në mënyrë demokratike përfaqësuesit e tyre”, thanë nga Ambasada Amerikane në Prishtinë. “Çdo përpjekje për të shkelur këtë parim bazë minon partneritetin mes Shteteve të Bashkuara dhe Kosovës”, tha për Radion Evropa e Lirë një zëdhënës i Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Edhe Bashkimi Evropian ka shprehur “shqetësim serioz” për dështimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) në Kosovë për t’i miratuar rezultatet përfundimtare për Listën Serbe - partinë më të madhe të serbëve në Kosovë - nga zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit. “BE-ja përsërit thirrjen e saj për depolitizimin e punës së KQZ-së, në përputhje me raportin e Misionit të BE-së për Vëzhgim të Zgjedhjeve, dhe u bën thirrje të gjitha partive të punojnë së bashku, në përputhje me Kushtetutën”, tha zëdhënësi i BE-së në një përgjigje për Radion Evropa e Lirë. Ai shtoi se është e rëndësishme që të gjithë kandidatët e zgjedhur të jenë në gjendje t’i marrin mandatet e tyre në Kuvendin e Kosovës. KQZ-ja i miratoi më 31 janar rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në Kosovë, por jo rezultatet për Listën Serbe. Moskonfirmimi i nëntë anëtarëve të Listës Serbe në Kuvendin e ardhshëm të Kosovës u dënua ashpër nga vetë partia dhe Beogradi zyrtar.



Tre anëtarë të KQZ-së votuan pro konfirmimit të rezultateve, dy anëtarë nga Lëvizja Vetëvendosje votuan kundër, ndërsa anëtarët e tjerë abstenuan. Lista Serbe, parti e cila mbështetet nga Beogradi, paraqiti një ankesë në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) më 2 shkurt, lidhur me vendimin e KQZ-së. Lista Serbe e përshkroi vendimin e 2 shkurtit si “të paligjshëm dhe diskriminues”, duke thënë se ai anulonte më shumë se 42 000 vota të fituara në zgjedhjet parlamentare të mbajtura më 28 dhjetor të vitit të kaluar. Në ato zgjedhje Lista Serbe fitoi nëntë nga dhjetë ulëset e rezervuara për komunitetin

serb. Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kosovë tha se po i monitoron nga afër zhvillimet dhe bëri thirrje për pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare zgjedhore. “Ne bëjmë thirrje për publikim transparent dhe gjithëpërfshirës të rezultateve të zgjedhjeve si një mjet për të siguruar siguri ligjore dhe trajtim të barabartë të të gjithë pjesëmarrësve në procesin zgjedhor”, tha OSBE-ja. Sipas KQZ-së, në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të mbajtura më 28 dhjetor, Lëvizja Vetëvendosje e kryeministrit në detyrë, Albin Kurti fitoi 51.10 për qind të votave, ose 57 ulëse parlamentare në Kuvendin e

Kosovës. Partia Demokratike e Kosovës fitoi 20.19 për qind të votave (22 ulëse), Lidhja Demokratike e Kosovës 13.24 për qind (15 ulëse), ndërsa Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës fitoi 5.50 për qind të votave, gjashtë ulëse në Kuvend. Nga dhjetë ulëset e rezervuara për komunitetin serb, nëntë u fituan nga Lista Serbe, ndërsa një shkoi për Partinë për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë të Nenad Rashiqit. Dhjetë ulëse të tjera janë të rezervuara për komunitetet joshumicë. Vendimin e KQZ-së e kritikuan një ditë më parë edhe Shtetet e Bashkuara. Ambasada Amerikane në Prishtinë i tha Radios Evropa e Lirë se vendimi i KQZ-së është

“në kundërshtim me të drejtën e qytetarëve për të zgjedhur në mënyrë demokratike përfaqësuesit e tyre”. “Çdo përpjekje për të shkelur këtë parim bazë minon partneritetin mes Shteteve të Bashkuara dhe Kosovës”. Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, me partinë e tij, Lëvizjen Vetëvendosje, pritet ta formojë pa probleme qeverinë e re. Megjithatë, ai e ka pranuar vetë një ditë më parë se do të duhet të krijohet një raport i ri mes pushtetit dhe opozitës për çështje të tjera madhore, siç është ajo e pozitës së presidentit apo miratimi i marrëveshjeve ndërkombëtare. Për të dyja proceset duhen siguruar dy të tretat e votave.


ME FTESË TË PRESIDENTIT TË EMIRATEVE, OSMANI UDHËTOI ZYRTARISHT PËR NË EMIRATET E BASHKUARA ARABE

PRISHTINË, 3 SHKURT - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka udhëtuar zyrtarisht në Emiratet e Bashkuara Arabe, ku do të marrë pjesë në Samitin Botëror të Qeverisjes, për ta forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar dhe për ta promovuar vizionin e Kosovës për zhvillim dhe inovacion. Presidentja Osmani në këtë Samit është ftuar nga



presidenti i Emirateve të Bashkuara Arabe, Lartmadhëria e Tij, Sheikh Mohamed bin Zayed Al Nahyan. Në Samit do të marrin pjesë edhe shumë liderë nga mbarë bota, me të cilët presidentja do të ketë takime bilaterale për të diskutuar mundësi bashkëpunimi dhe projekte të përbashkëta strategjike. Gjatë vizitës presidentja Osmani do të marrë pjesë në

sesione kyçe të Samitit, ku do të mbajë ndër fjalimet kryesore. Ajo, gjithashtu, do të marrë pjesë në sesione të ndryshme të forumit dhe tryeza tematike. Samiti Botëror i Qeverisjes shërben si një platformë globale që bashkon liderë, organizata ndërkombëtare e kompani për të diskutuar të ardhmen e qeverisjes dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.



A DO TË JENË OBJEKT I HETIMIT EDHE KANDIDATËT PËR DEPUTET QË U KANË SHTUAR VOTAT?

Ulje-ngritjet e konsiderueshme të partive politike në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit në Kosovë ranë shpejt në hije, kur nisi të zbulohej ajo që duket se është shkallë e gjerë e manipulimit me vota të kandidatëve për deputetë. Nga të gjitha partitë, në disa qytete. Koordinatorja për zgjedhje, Laura Pula, ka bërë me dije se në hetime do të përfshihen edhe kandidatët që u janë shtuar vota. Një gjë të tillë e kanë kërkuar edhe organizatat që merren me proceset zgjedhore në vend

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 3 SHKURT - Policia e Kosovës po interviston të dyshuar në komunën e Vitisë për manipulim të votave të kandidatëve për deputetë për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit. "Policia e Kosovës me autorizime të Prokurorisë Themelore në Gjiilan ka filluar intervistat lidhur me manipulimet e rezultateve zgjedhore në regionin e Gjiilanit", tha për Radion Evropa e Lirë kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gjiilan, Arben Kadriu, duke shtuar se konkretisht bëhet fjalë për komunën e Vitisë. Kadriu nuk saktësoi se sa persona po intervistohen nga policia më 3 shkurt. Deri më tani, për shkak të dyshimeve për manipulim të votave, janë ndaluar dhjetëra persona në disa rajone të Kosovës dhe janë intervistuar qindra të tjerë.

Hetime po zhvillohen në Prizren, Malishevë, Podujevë, Ferizaj dhe Mitrovicë. Koordinatorja nacionale për zgjedhje, Laura Pula, e ka cilësuar procesin e 28 dhjetorit si ndër proceset "më të kompromentuar", pasi u vërejtën mospërputhje të mëdha të votave të kandidatëve për deputetë pas një rinumërimi të pjesshëm të urdhëruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Më pas, Komisioni urdhëroi rinumërim të plotë të votave që përfundoi në fundjavën që shkoi. Pula është shprehur se edhe kandidatëve që u ishin shtuar votat do të jenë objekt i hetimit, por deri më tani nuk është bërë me dije nëse ndaj ndonjërit prej tyre kanë nisur procedura hetimore. Edhe Demokracia në Veprim ka vlerësuar se gjetjet e deritanishme krijojnë bazë të mjaftueshme që organet e drejtësisë ta trajtojnë këtë çështje me prioritet dhe me një qasje të koordinuar dhe hetim

gjithëpërfshirës në nivel vendi. "Në mënyrë të veçantë, DnV vlerëson se hetimi duhet të shtrihet përtej nivelit teknik të procesit të numërimit. Modelet e përsëritura të devijimeve në favor të kandidatëve të caktuar brenda dhe nëpër komuna të caktuara, krijojnë bazë të arsyeshme për dyshimin se këto nuk janë produkte të gabimeve njerëzore apo të rastësisë, por të veprimeve të qëllimshme të komisionarëve. Për rrjedhojë, edhe kandidatët që rezultojnë përfutues nga këto mospërputhje dhe manipulime duhet të jenë pjesë e hetimeve, në mënyrë që të sqarohet nëse ka pasur nxitje, koordinim apo përfshirje direkte apo indirekte në manipulimin e votës", ka theksuar DnV-ja. Drejtori i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka vlerësuar se rastet në Podujevë, Pejë e komuna të tjera po dëshmojnë se manipulimi i votave nuk ka qenë rastësor. "Rastet në Podujevë, Pejë e komuna të tjera po dëshmojnë se manipulimi i votave nuk ka qenë as rastësor dhe as i izoluar. Ai ka qenë i orkestruar dhe gjithëpërfshirës, duke mos u kufizuar në një komunë, një kandidat apo një subjekt të vetëm politik. Kjo e thellon ndjeshëm dëmin ndaj besimit publik në procesin zgjedhor", ka thënë ai. Kryeziu ka thënë se fakti që shumica e kandidatëve, edhe pas largimit të votave të keqpërdorura, mund të certifikohen si deputetë, nuk e zhbën këtë dëm. "Përkundrazi, krijon një precedent të

rrezikshëm: manipulimi shndërrohet në një strategji me kosto të ulët, ku përgjegjësia penale bie mbi komisionarët, ndërsa përfitimi politik mbetet te kandidatët dhe partitë. Kështu krijohet një paradoks serioz: procesi pranohet si i rregulluar ligjërisht, por mbetet i komprometuar moralisht. Për mua kjo është e qartë. Për kandidatët dhe partitë e tyre, pyetja thelbësore mbetet: a është i pranueshëm një mandat politik i ndërtuar mbi një proces të manipuluar, edhe nëse ai më pas korrigjohet? Në demokraci, ligjshmëria formale nuk mjafton pa legjitimitet etik dhe moral", ka thënë Kryeziu. Pas përfundimit të rinumërimit, më 31 janar KQZ-ja ka shpallur rezultatet përfundimtare. Pas kësaj, kandidatët dhe partitë kanë të drejtë ankese në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia dhe më pas edhe në Gjykatën Supreme. Vetëm pas përfundimit të afateve për ankese në këto dy institucione, mund të bëhet certifikimi i rezultateve, duke i hapur rrugë formimit të institucioneve të reja të vendit. Lëvizja Vetëvendosje është fituesja e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, duke marrë 51.10 për qind të votave dhe do të ketë 57 deputetë në Kuvendin e ri të Kosovës. Partia Demokratike e Kosovës ka fituar 20.19 për qind të votave, apo 22 deputetë, Lidhja Demokratike e Kosovës ka fituar 13.24 për qind dhe do të ketë 15 deputetë, ndërsa Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, 5.50 për

qind të votave apo gjashtë deputetë. Nga ulëset e rezervuara për minoritetin serb, nëntë ulëse i ka fituar Lista Serbe dhe një ulëse, Partia për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë.

Si ndodhi manipulimi?

Në qendrat komunale të numërimit, secili fletëvotim iu nënshtrohet disa kontrolleve. Fillimisht fletëvotimi lexohet me zë të lartë nga një numërues, më pas shfaqet në ekran përmes kamerës dhe regjistrohet në sistem elektronik nga një zyrtar tjetër, ndërsa një person i tretë e verifikon fletën. E manipulimi besohet se bëhet në fazën e leximit të votave për kandidatë. Numëruesi mund ta ndryshojë verbalisht numrin e kandidatit të votuar, duke e zëvendësuar me numrin e një kandidati tjetër. Kështu, sistemi regjistron votë për kandidatin e gabuar, edhe pse fletëvotimi real tregon diçka tjetër. Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, çdo manipulim i qëllimshëm i votës apo rezultatit zgjedhor përbën vepër penale dhe dënohet me deri në pesë vjet burgim.

KOSOVA, SHQIPËRIA DHE KROACIA THELLOJNË BASHKËPUNIMIN TREPALËSH NË FUSHËN E MBROJTJES

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 3 SHKURT - Në bazë të Deklaratës së përbashkët trepalëshe, të nënshkruar në vitin 2025 nga ministri i Mbrojtjes së Kosovës, ministri i Mbrojtjes së Kroacisë dhe ministri i Mbrojtjes së Shqipërisë u mbajt takimi trepalësh në nivelin e drejtorëve të Politikave të Mbrojtjes dhe Armatimeve. Ky aktivitet përbën një nga veprimet në kuadër të zbatimit të fushave të bashkëpunimit të dakorduara ndërmjet palëve. “Delegacioni i Republikës së Kosovës u udhëhoq nga drejtori i Politikave të Mbrojtjes, Fauk Geci, ku u shkëmbyen mendime lidhur me mundësitë për avancimin e bashkëpunimit të përbashkët në fushën e

aftësive mbrojtëse, bashkëpunimin ndërmjet industrive mbrojtëse të vendeve nënshkruese, si dhe hapat e mëtejme për zbatimin e Deklaratës”, ka njoftuar Ministria e Mbrojtjes e Kosovës. Në njoftim theksohet se deklarata e përbashkët përcakton katër fusha kryesore të bashkëpunimit të mëtejme trepalësh, të cilat përfshijnë promovimin e bashkëpunimit në fushën e aftësive mbrojtëse dhe industrisë mbrojtëse, rritjen e ndërveprueshmërisë përmes arsimit, trajnimit dhe ushtrimeve të përbashkëta, adresimin e kërcënimeve hibride dhe forcimin e qëndrueshmërisë, si dhe ofrimin e mbështetjes së vazhdueshme dhe të plotë për integrimin euroatlantik. Po ashtu, sipas Ministrisë së

Mbrojtjes së Kosovës, deklarata e përbashkët trepalëshe konfirmoi angazhimin për forcimin e mëtejme të bashkëpunimit trepalësh në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes ndërmjet Kroacisë, Shqipërisë dhe Kosovës, me synim rritjen e sigurisë dhe stabilitetit në Evropën Juglindore. Në këtë kuadër u theksua rëndësia e përpjekjeve të koordinuara për adresimin e sfidave të reja të sigurisë, kërcënimeve hibride dhe rreziqeve të tjera që mund të cenojnë stabilitetin rajonal dhe atë ndërkombëtar. Kur ministri i Mbrojtjes, Ejup Meqedonci, kishte vënë nënshkrimin në deklaratën trepalëshe, pati deklaruar se Shqipëria, Kroacia dhe Kosova do të jenë bashkë edhe më fuqishëm përballë sfidave dhe

synimeve të përbashkëta në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë. “Duke u nisur nga vlerat tona të përbashkëta, nga orientimet e njëjtoja gjeostrategjike dhe angazhimet e ndërsjella për bashkëpunim rajonal, Shqipëria, Kroacia dhe Kosova deklarohen për forcim të bashkëpunimit dhe avancim të hapave për mbrojtjen e territoreve dhe të njerëzve tanë; për të kontribuar për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare; si dhe për prodhimtarinë e industrisë së mbrojtjes. Për këtë, Shqipëria, Kroacia dhe Kosova, do të angazhohen për forcimin e lidhjeve mes tyre, rritjen e ndërveprueshmërisë mes ushtrive të tri shteteve tona përmes edukimit, trajnimeve dhe stërvitjeve të përbashkëta; rritjen e angazhimit për t’i

luftuar kërcënimet hibride dhe për t’u mbrojtur prej tyre; bashkërendimin e politikave për integritet euroatlantike dhe me theks të veçantë ndihmën e nevojshme ndaj Kosovës për t’u integruar në nisma rajonale të mbrojtjes dhe të sigurisë”, kishte deklaruar Maqedonci, duke shtuar se kjo deklaratë, sikur edhe i tërë bashkëpunimi i Shqipërisë, Kroacisë dhe Kosovës në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, rrjedhë nga fryma e miqësisë ndërshtetërore dhe e angazhimit të përbashkët për fqinjësi të mirë, për paqe dhe siguri. “Ky bashkëpunim yni nuk është kërcënim ndaj askujt, por angazhim shtesë për ta ruajtur paqen dhe stabilitetin rajonal në Ballkanin Perëndimor”, kishte thënë Maqedonci.



POLICIA SËRISH GJEN ARMË NË VERI, MUNICION DHE MJETE TË TJERA ILEGALE

PRISHTINË, 3 SHKURT - Në vazhden e pranimin të informacioneve nga ana e qytetarëve, të martën Policia e Kosovës ka pranuar informacion se në një bodrum të një ndërtese në rrugën “Vasilije Ostroski”, në Mitrovicë në veri, mund të ketë mjete te dyshimta ilegale. Pas pranimin të informacionit, policia ka ndërmarrë veprime të menjëhershme, ku gjatë kontrollit, përkatësisht në një bodrum kolektiv të ndërtesës, ka gjetur dhe sekuestruar: tri

armë të gjata, një tytë vazhduese, një kondak për armë të gjatë, 764 fishekë të kalibrave të ndryshëm, 14 karikatorë, 10 krehër për fishekë, një granatë dore tymuese, dy antiplumba ushtarakë, katër mostra të ndryshme të ADN-së, dy jakne ushtarake, një bluzë e uniformes ushtarake, një palë pantallona ushtarake, mbështjellës me material tekstili dhe shirita ngjitës. Lidhur me rastin është njoftuar Prokurori i Shtetit, i cili ka

udhëzuar iniciimin e rastit për veprën penale: “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”. Në lidhje me këtë rast nuk ka persona të arrestuar, ndërsa rasti mbetet nën hetime. Policia e Kosovës ka falënderuar qytetarët për bashkëpunimin dhe ndihmën e vazhdueshme, si dhe i inkurajon që çdo rast të dyshimtë apo veprim të kundërligjshëm ta raportojnë në numrin emergjent 192 ose në stacionin më të afërt policor.



Hyn në fuqi marrëveshja Kosovë - Itali për eliminimin e tatimit të dyfishtë

PRISHTINË, 3 SHKURT - Marrëveshja ndërmjet Kosovës dhe Italisë për eliminimin e tatimit të dyfishtë, parandalimin e evazionit fiskal dhe shmangies së tij, ka hyrë

zyrtarisht në fuqi. Lajmi është bërë me dije nga Ambasada e Kosovës në Itali, e cila ka njoftuar qytetarët dhe komunitetin e biznesit për përfitimet konkrete që sjell kjo marrëveshje për

individët dhe investorët në të dyja shtetet. Marrëveshja garanton që të ardhurat të mos taten dy herë, si në Kosovë ashtu edhe në Itali, ndërsa tatimi i paguar në njërin shtet njihet

si kredit tatimor në shtetin tjetër, në përputhje me rregullat përkatëse. Po ashtu, ajo përcakton rregulla të qarta për tatimin e pagave, profesioneve të lira dhe veprimtarive afariste.



DËNOHET ME 12 VJET E 6 MUAJ BURGIM SËRGJAN LAZOVIQ PËR KRIME LUFTE

PRISHTINË, 3 SHKURT - Gjykata Themelore në Prishtinë ka shqiptuar aktgjykimin ndaj të akuzuarit për krime lufte Sërgjan Lazoviq, duke e dënuar me 12 vjet e gjashtë muaj burgim.

Lazoviqit u dënua për krime të kryera në Panorc të Malishevës gjatë luftës së fundit në Kosovë, raporton “Betimi për Drejtësi”. Aktakuza ndaj tij ishte ngritur më 2024 nga Prokuroria Speciale e Kosovës. Sipas aktakuzës të siguruar nga kjo medie e specializuar në raportime në fushën e drejtësisë, Lazoviq akuzohej se në periudhën 1998-1999, në fshatin Panorc të Malishevës, në bashkëkryerje me persona të tjerë ende të pidentifikuar kishin kryer arrestime të kundërligjshme, keqtrajtime fizike dhe psikike të popullsisë civile shqiptare, që nuk ishin të përfshirë në luftë.

Aktakuza thotë se nga 3 shtatori i vitit 1998 deri më 5 tetor të po atij viti, në Panorc, Lazovi, si person i uniformuar, së bashku me pjesëtarë të tjerë të forcave policore dhe ushtarake serbe me qëllim të frikësimit, dëbimit



masiv dhe spastrimit etnik të popullatës shqiptare, ai kishte arrestuar, ndaluar, torturuar, maltretuar fizikisht dhe psikikisht rreth 500 civilë. Prokuroria ka argumentuar se banorë të fshatrave të Malishevës dhe Klinës u detyruan të largoheshin nga shtëpitë e tyre, duke shkuar në drejtim të bjeshkëve të fshatit

Panorc dhe me të arritur aty, civilët hasën në një postbllok të forcave policore serbe. Aktakuza thotë se forcat serbe fillimisht i ndan burrat nga gratë dhe fëmijët, duke i urdhëruar këta të fundit që të largoheshin. Ndërkaq, rreth 500 burra shqiptarë u arrestuan dhe u dërguan në drejtim të shkollës së fshatit dhe rrugës u

keqtrajtuar dhe rrahën.

Në këtë shkollë burrat ishin mbajtur të bllokuar për rreth 30 orë, dhe në një klasë ata dërgoheshin për t'u marrë në pyetje, ku edhe rriheshin e torturoheshin, thuhet në aktakuzë, ku shtohet se 13 prej të ndaluarve u dërguan më pas në Burgun e Dubravës dhe të tjerët u liruan.

Lazaroviq dhe pjesëtarë të tjerë të forcave serbe, po ashtu, akuzohen se dëbuan popullsinë shqiptare dhe më pas plaçkitën shtëpitë e tyre.

Së voni, Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur një sërë aktakuzash për krime lufte në Kosovë. Ndërkaq, që nga përfundimi i luftës dhjetëra persona janë dënuar për këto krime para institucioneve vendore dhe ndërkombëtare.

Fillimisht pas luftës, përkatësisht nga viti 2000 dhe 2008, krimet e luftës në Kosovë u hetuan nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), ndërsa nga viti 2008 nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit (EULEX).

Më 2018 EULEX-i ia dorëzoi lëndët organeve vendore të drejtësisë.

Gjatë luftës në Kosovë, nga viti 1998 deri në 1999, janë vrarë më shumë se 13 000 civilë, ndërsa mijëra të tjerë janë zhdukur.

Më shumë se 1 500 persona vazhdojnë të jenë ende të pagjetur, pjesa më e madhe e tyre shqiptarë.



Kryetari i Rahovecit priti nxënësit e përfshirë në projektin për mendimin kritik dhe angazhimin qytetar

RAHOVEC, 3 SHKURT - Kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi, ka pritur të martën në takim përfaqësuesit e “Teach for Kosova” dhe nxënësit e shkollave të mesme “Xhelal Hajda - Toni” dhe “Selajdin Mullabazi - Mici”, të përfshirë në projektin “Promoting Critical Thinking and Active Citizenship Among Youth”, ku përmes një programi jashtëprogramor

zhvilluan mendimin kritik, vetëbesimin dhe angazhimin qytetar. “Mora pyetje interesante, dëgjova ide dhe reflektime të pjekura që dëshmojnë potencialin e tyre për të qenë zë aktiv në shoqëri. Rinia e informuar, e guximshme dhe e angazhuar është shtyllë e fortë për zhvillimin dhe përparimin e vendit”, ka shkruar Latifi në “Facebook”.



Kryetari i Fushë-Kosovës dorëzon 60 dosje për hetim në Krimet Ekonomike

FUSHË-KOSOVË, 3 SHKURT - Kryetari i komunës së Fushë-Kosovës, Valon Prebreza, ka thënë se ka dorëzuar mbi 60 dosje për hetim në Krimet Ekonomike të Policisë së Kosovës. Ai ka njoftuar në “Facebook” se bëhet fjalë për dëmtim të interesit publik dhe dyshime të keqpërdorimit të detyrës zyrtare.

“Sot po dorëzohen mbi 60 dosje për hetim në Krimet Ekonomike të Policisë së Kosovës për dëmtimin e interesit publik dhe dyshimit të keqpërdorimit të detyrës zyrtare nga ish-qeverisja. Gjithmonë në shërbim të qytetarëve dhe të ligjshmërisë”, ka shkruar Prebreza.

“Liria ka Emër” merr mbështetje edhe nga Suhareka për marshin “Drejtësi, jo politikë” më 17 shkurt

SUHAREKË, 3 SHKURT - Përfaqësuesit e platformës “Liria ka Emër”, Eliza Hoxha dhe Ismail Tasholli, kanë vizituar komunën e Suharekës, ku janë pritur nga kryetari Bali Muharremaj, i cili u ka dhënë mbështetje për marshin “Drejtësi, jo politikë”, që do të mbahet më 17 shkurt në Prishtinë, në mbrojtje të drejtësisë së paanshme dhe të vlerave të luftës çlirimtare. Në këtë takim Hoxha dhe Tasholli kanë paraqitur aktivitetet në kuadër të platformës dhe kanë shprehur

mirënjohje për përkrahjen e ofruar nga komuna e Suharekës. “Mbështetja që po marrim nga komunat dhe nga kryetarët e tyre është dëshmi se kjo kauzë është mbi politikën ditore”, tha Hoxha. Ndërkaq Tasholli tha se ky marsh është një thirrje qytetare për respektimin e parimeve të drejtësisë, dinjitetit njerëzor dhe për ndarjen e qartë të drejtësisë nga politika. Kryetari i komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, u zotua se do të angazhohet

maksimalisht për mobilizimin e qytetarëve për pjesëmarrje në marshin e 17 shkurtit. “Këtij marshi për çlirimtarët në Hagë duhet t’i përgjigjen me pjesëmarrje të gjithë qytetarët e Kosovës”, deklaroi Muharremaj. Platforma “Liria ka Emër” do të vazhdojë takimet dhe aktivitetet në tërë komunat e Kosovës dhe me të gjithë aktorët e rëndësishëm të shoqërisë për mobilizim sa më të gjerë qytetar për marshin e 17 shkurtit, me moton “Drejtësi, jo politikë”.



AZEMI PARALAJMËRON NDËRPRERJE PUNE PËR KOMPANITË QË NUK ZBATOJNË PAGËN MINIMALE



PRISHTINË, 3 SHKURT - Kryetari i Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat, Jusuf Azemi, ka deklaruar se nga 1 janari i këtij viti paga minimale në Kosovë duhet të jetë 425 euro në përputhje me vendimin e Qeverisë së Kosovës, duke paralajmëruar masa sindikale ndaj kompanive që nuk e zbatojnë këtë vendim. Në një intervistë për Ekonomia Online, Azemi tha se gjatë muajit dhjetor dhe deri në mesin e janarit sindikata ka njoftuar të gjitha kompanitë dhe

institucionet që pagat nën 425 euro duhet të rregullohen sipas vendimit qeveritar. “Gjatë muajit dhjetor deri në mesin e janarit kemi paralajmëruar të gjitha kompanitë dhe institucionet që pagat nën 425 euro duhet të bëhen 425 euro, konform vendimit të Qeverisë së Kosovës. Pra, paga minimale tani, nga 1 janari deri më 1 korrik, është 425 euro, ndërsa nga 1 korriku do të jetë 500 euro. Në njëfarë forme, ne nuk jemi pajtuar plotësisht, por është

nxjerrë një vendim që duhet respektuar”, tha ai. Ai bëri me dije se aktualisht vetëm një kompani e ka shkelur këtë vendim, ndërsa për kompanitë e tjera tha se ende është herët të flitet. “Tani për tani kemi vetëm një kompani që e ka thyer këtë vendim, sepse për kompanitë e tjera është herët të flasim. Duhet të presim datën 5, eventualisht 6 shkurt, dhe të shohim sa kompani janë duke e respektuar këtë vendim dhe sa

jo. Të gjitha ato kompani që nuk e bëjnë pagën në këtë shumë do të kenë një afat njëjavor. Në të kundërtën, ne jemi të obliguar, në bazë të vendimit të kryeministrit, ta ndërpresim punën derisa të bëhet pagesa shtesë, gjegjësisht pagesa prej 396 eurosh, që i bie pagë neto për secilin punëtor”, tha Azemi. Duke folur për nivelin e pagës minimale, ai theksoi se sipas kalkulimeve të sindikatës, kjo pagë nuk i mbulon shpenzimet

minimale jetësore të një familjeje. “Realisht, sipas një kalkulimi që kemi bërë, shpenzimet minimale për një familje me katër anëtarë nuk mund të mbulohen me këtë shumë sa është paga minimale. Megjithatë, qeveria ka marrë një vendim të njëanshëm. Së paku do të duhej të kishte një fazë kalimtare duke filluar nga 600 euro por, megjithatë, kjo është situata aktuale dhe ne duhet ta respektojmë deri në një ndryshim tjetër”, tha ai.

Prishtina radhitet kryeqyteti më i lirë në Evropë

PRISHTINË, 3 SHKURT - Prishtina renditet kryeqyteti më i lirë në Evropë sa i përket kostos së jetesës, qirave, çmimeve të ushqimeve dhe në restaurante.

Megjithatë, edhe fuqia blerëse është ndër më të ulëtat, duke lënë prapa vetëm Athinën, Shkupin, Beogradin, Lisbonën, Kievin, Kishinjevin

dhe Tiranën, raporton REL. Shifrat tregojnë koston e jetesës në qytete të ndryshme, krahasuar me Nju-Jorkun. Kur një indeks ka vlerën 80, ai

qytet është më i lirë se Nju-Jorku për 20 për qind. Nëse indeksi ka vlerën 120, qyteti është më i shtrenjtë se Nju-Jorku për 20 për qind.



FERRONIKELI PAS DY DEKADASH PRIVATIZIM: 80 PUNËTORË, ZERO PRODHIM

PRISHTINË, 3 SHKURT - Nga rreth 700 punëtorë aktivë, kompania për prodhimin dhe përpunimin e nikelit dhe produkteve të tij, Ferronikeli, sot numëron vetëm 80 të punësuar në administratë, ndërsa makineritë e prodhimit janë plotësisht të ndalura tash e sa kohë. Dikur një nga shtyllat kryesore të industrisë metalurgjike dhe ekonomisë së Kosovës, kompania që eksportoi produkte në vlerë mbi 80 milionë euro vetëm në vitin 2020, sot përballet me një realitet të zymtë: prodhim zero, kontrata të ndërprera dhe pritje për kushte më të favorshme tregu. Që nga privatizimi i saj kanë kaluar dy dekada, por rimëkëmbja vazhdon të mbetet sfidë.

Nga simbol ekonomik në kompleks pothuajse të boshatisur

Ferronikeli, i vendosur në qytetin e Drenasit - rreth 34 kilometra nga Prishtina - ishte për vite me radhë simbol i fuqisë industriale të Kosovës. Sot kompleksi industrial duket pothuajse i boshatisur. Shumica e punëtorëve kanë mbetur pa kontrata pune, ndërsa prodhimi është ndalur tërësisht. Zyrtarë të kompanisë shprehin optimizëm se makineritë do të ndizen sërish, por kur kushtet e tregut, sipas tyre, të jenë më të favorshme. Ata thonë se kompania mbetet e përkushtuar për rikthimin e prodhimit dhe se, edhe gjatë periudhës së ndaljes, janë realizuar investime prej miliona eurosh në teknologjinë e prodhimit dhe mbrojtjen e mjedisit, për të qenë të gatshëm në momentin e rihapjes.

Pse u ndal prodhimi?

Sipas Shpend Gudaqit, udhëheqës i zyrës për ndërlidhje me komunitetin dhe marrëdhënie me publikun në kompaninë NewCo Ferronikeli Complex, faktorët kryesorë që çuan në ndaljen e prodhimit lidhen me tregjet ndërkombëtare. “Gjatë viteve të fundit çmimi i nikelit në bursat ndërkombëtare dhe çmimi i energjisë elektrike në tregjet evropiane kanë qenë të pafavorshme për prodhim të qëndrueshëm në fabrikë”, thotë ai për Radion Evropa e Lirë. Për pasojë, kompania ka qenë e detyruar të ndërmarrë masa drastike për uljen e kostove. “Një nga vendimet më të rëndësishme ishte fikja e furrës elektrike në mars të vitit 2025, për të zbutur koston e lartë të energjisë elektrike”, shpjegon Gudaqi. Ferronikeli shpenzon deri në 420 mijë megavate orë energji elektrike në vit.



Historiku i Ferronikelit

Ferronikeli u ndërtua në vitin 1984 dhe përbëhet nga dy linja prodhimi, dy furra elektrike dhe dy furra rrotulluese. Xeherori i nikelit sigurohet nga minierat e Çikatovës dhe Gllavicës si dhe nga Shqipëria e vende të tjera. Rënia e prodhimit nisi që në vitet '90, pas vendosjes së masave represive nga regjimi i atëhershëm serb. Deri atëkohë ndërmarrja ishte një nga prodhuesit kryesorë të nikelit në rajon. Pas luftës, në vitin 2006, ajo u privatizua nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit - sot Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Fillimisht u ble nga një kompani me seli në Londër për 30.5 milionë euro, me kusht që të punësonte deri në 1 000 punëtorë dhe të investonte 20 milionë euro, sipas zotimeve kontraktuale. Një vit pas privatizimit, nisi prodhimi nën emrin NewCo Ferronikeli. Pas më shumë se një dekadë operim, në vitin 2018 kompania ndryshoi pronësinë, duke kaluar nën menaxhimin e një kompanie tjetër britanike, ku pjesë e strukturës pronësore ishte edhe një kompani nga Shqipëria. Në vitin 2022, pastaj, Ferronikeli kaloi në duart e konsorciumit aktual turk, Yildirim Group.

Që nga viti 2017 energjia blihet drejtpërdrejt nga tregjet e jashtme, pa u furnizuar nga brenda Kosovës. Me çmimet aktuale në bursën hungareze HUPLEX - mbi 140 euro për megavat orë - kostoja vjetore e energjisë, në rast prodhimi, do të arrinte mbi 58 milionë euro, shumë kjo që rrit presionin mbi qëndrueshmërinë e fabrikës.

Shkëputja e kontratave dhe një sinjal shprese

Në fund të vitit 2025 kompania u përball me një vendim edhe më të vështirë: shkëputjen kolektive të kontratave të punës për mbi 600 punëtorë, edhe pse ata ishin paguar për gati dy vjet pa prodhim aktiv. “Procesi është zbatuar në përputhje me Ligjin e Punës, duke përmblusur të gjitha detyrimet ndaj punonjësve deri në nëntor të vitit të kaluar”, thotë Gudaqi. Disa medie kanë raportuar më parë se, kur kushtet e tregut të mundësojnë rifillimin e prodhimit në Ferronikel, punonjësit e prekur do të kenë prioritet për t'u rikthyer në vendet e tyre të punës. E zhvillimet e fundit në tregjet botërore kanë sjellë një sinjal të kujdesshëm shprese. Nga mesi i dhjetorit 2025 deri në janar 2026,

çmimi i nikelit është rritur nga rreth 14 200 dollarë në 18 900 dollarë për ton - një rritje që mund të ndikojë në rishikimin e planeve të prodhimit.

“Me pagën e Ferronikelit e mbajta familjen”

Për Rexhep Ademin, mbi 50 vjeç, Ferronikeli nuk ishte vetëm vend pune. Për 18 vjet me radhë ai ishte burimi kryesor i sigurisë ekonomike për familjen e tij. Prandaj, momenti kur u njoftua për shkëputjen e kontratës së punës mbetet një nga më të rëndët në jetën e tij profesionale. “Me pagën e Ferronikelit e kam mbajtur familjen”, thotë Ademi për Radion Evropa e Lirë, duke kujtuar vitet kur stabiliteti i kompleksit garantonte edhe stabilitet për qindra familje në Drenas dhe më gjerë. Pas ndërprerjes së prodhimit, Ademi arriti të gjente një punë tjetër, por dëshira që Ferronikeli ta rifillojë punën mbetet ende e gjallë. “Do të kthehesha vetëm me kushte më të mira dhe me pagë më të lartë, jo me atë që ka qenë më parë”, thotë ai. Sipas Ademit, paga mesatare për punëtorët teknikë në Ferronikel ka qenë mbi 550 euro, në varësi të përvojës, viteve të punës dhe pozitës që mbanin. Kapaciteti i prodhimit ndër vite arriti deri në 6 000 tonë nikel në

vit, duke e bërë Ferronikelin një nga eksportuesit më të mëdhenj të vendit. Vetëm gjatë vitit 2020 kompania realizoi eksporte në vlerë mbi 80 milionë euro. Agjencia Kosovare e Privatizimit e ka monitoruar punën e ndërmarrjes deri në korrik të vitit 2009 dhe, si rezultat i përmblusjes së zotimeve kontraktuale, ka vendosur ta lirojë atë nga monitorimi dhe raportimi i mëtejshëm, thuhet në një përgjigje të kësaj agjencie për Radion Evropa e Lirë.

Kritika ndaj privatizimit dhe pasojat ekonomike

Profesori Izet Ibrahim, nga Fakulteti i Gjeoshkencave në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë të Jugut, thotë se institucionet shtetërore duhet të tregojnë angazhim më serioz dhe ta rishikojnë procesin e privatizimit. “Procesi duhet të rikthehet në pikën para privatizimit dhe ndërmarrja të riprivatizohet mbi baza të qarta dhe transparente”, thotë ai për Radion Evropa e Lirë. Sipas Ibrahimit, Ferronikeli ka kontribuar deri në 10 për qind të Bruto Produktit Vendor, ndërsa ndalja e prodhimit ka thelluar deficitin tregtar dhe ka ndikuar negativisht në gjithë zinxhirin industrial të vendit. “... sepse

ndërprerja e prodhimit në kompleks nuk ndikon vetëm në pagat e punëtorëve, por ka pasoja të drejtpërdrejta edhe në buxhetin e shtetit dhe në ekonominë e përgjithshme të vendit”, thotë Ibrahim. Nga kompania NewCo Ferronikeli Complex thonë se kanë bashkëpunim të vazhdueshëm me institucionet qendrore dhe lokale dhe se, brenda kornizave ligjore, kanë hasur në mirëkuptim. “Insistimi ynë është që kompania, edhe pse private, të trajtohet si pasuri kombëtare dhe aset strategjik, pasi është eksportuesja më e madhe dhe një nga punëdhënëset kryesore në Kosovë”, thuhet në deklaratën e kompanisë. Gudaqi shton se janë të hapur për bashkëpunim me institucionet, me synimin për të gjetur zgjidhje që do të mundësojnë rikthimin e prodhimit dhe të punëtorëve në vendet e punës. Radio Evropa e Lirë pyeti Qeverinë e Kosovës dhe Ministrinë e Ekonomisë nëse ka pasur ndonjë kërkesë zyrtare nga Ferronikeli për gjetjen e një zgjidhjeje dhe nëse ekzistojnë mundësi ligjore për ndërmarrjen e ndonjë mase. Nga Ministria e Ekonomisë thanë se qeveria nuk ndërhyr në menaxhimin e kompanive private dhe se nuk janë në dijeni që kompania në fjalë ka adresuar ndonjë çështje drejtpërdrejt pranë këtij institucioni.

Efektet zinxhirore në ekonomi

Ndalimi i prodhimit nuk ka prekur vetëm punëtorët e Ferronikelit. Kompania shtetërore, Trainkos, e cila ofron shërbime të transportit hekurudhor në Kosovë, në Planin e Biznesit për vitin 2025 kishte paraparë transport për eksportin dhe importin e xeheroreve dhe të produktit final të Ferronikelit në vlerë prej rreth një milion eurosh - ose 430 mijë tonë xehe. Përveç kësaj, edhe disa kompani private kishin kontrata aktive për kryerjen e punëve në terren, të cilat janë ndikuar drejtpërdrejt nga ndalja e prodhimit. Në Kosovë, procesi i privatizimit ka nisur në vitin 2003 nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit dhe ka vazhduar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit pas vitit 2008. Deri tani janë privatizuar mbi 2.300 asete në vlerë prej qindra miliona eurosh. Megjithatë, procesi është kritikuar për disa arsye, të lidhura me efikasitetin, transparencën dhe pasojat ekonomike.

“NDIHEM SI NJË IDIOT” IU ZBULUAN MESAZHET ME EPSTEIN, LAJÇAK: KAM QENË NË APARTAMENTIN E TIJ, POR S’KISHTE VAJZA!

Diplomati sllovak, Miroslav Lajčak ka dhënë një intervistë pasi emri i tij doli në dosjen e Jeffrey Epstein, ku rezultoi se kishte shëmbyer një sërë mesazhesh me pedofilin e dënuar.

Pas publikimit të këtyre mesazheve, ai dha dorëheqjen nga posti i këshilltarit të kryeministrit sllovak Robert Fico.

“Sinqerisht nuk më kujtohen ato mesazhe”, tha diplomati në një intervistë për Radio Slovakia, duke iu referuar shkëmbimeve që përfshinin vajza. “Nuk mund t’i konfirmoj, por as nuk mund t’i mohoj”, duke shtuar se ndihej si “idiot”.

“Por kjo nuk më liron nga përgjegjësia”, tha ai. “Unë tregova gjykim të dobët dhe komunikim të papërshtatshëm. Ato mesazhe nuk ishin gjë tjetër veçse ego mashkullore budallaqe në veprim shaka mashkullore të vetëkënaqura”.

Lajcak shpjegoi se shkoi në Nju Jork në vitin 2017 për të filluar një post njëvjeçar në Kombet e Bashkuara dhe u prezantua me Jeffrey Epstein nga një diplomat i lartë i huaj.

Sipas Lajçak, Epstein ishte i njohur gjerësisht dhe u takua me figura të shumta biznesi dhe politike nga SHBA-ja dhe jashtë



saj.

Lajčak tha se nuk shihte asnjë arsye për të mos e takuar atë, duke argumentuar se krijimi i kontakteve ishte pjesë e punës



së tij. “Pse nuk duhet ta pranoj unë, një djalë nga Sllovakia, këtë?” tha ai. “Ai ishte një kontakt i vlefshëm.” Ai tha se më vonë u vu në dijeni të dënimit të Epstein

në vitin 2008 për një krim seksual, por vuri në dukje se shumë figura me ndikim vazhduan të shoqëroheshin me të edhe më pas. Kjo, tha ai, e bëri

të besonte se nuk kishte problem të bënte të njëjtën gjë.

“Marrëdhënia ime me të kishte të bënte me fjalë, jo me vepra. Sot po paguaj çmimin për komunikimin me të dhe për njohjen e tij”, tha diplomati, duke dënuar krimet që dolën në dritë pas arrestimit të Epstein në vitin 2019.

Ai konfirmoi gjithashtu se kishte vizituar apartamentin e Epstein, por tha se figura të tjera të biznesit dhe politikës ishin të pranishme.

“Nuk kishte vajza. Kjo pjesë e jetës së Epstein ishte përtej meje. Ai nuk foli për këtë dhe unë nuk pyeta. Ndërgjegjja ime është e pastër.”, theksoi ai.

Lajčak mohoi gjithashtu se ish-kryestrategu i Shtëpisë së Bardhë, Steve Bannon ishte takuar me Robert Ficon, pavarësisht mesazheve të publikuara që sugjeronin një takim të mundshëm.

“Nuk e dua Lavrovin”, tha Lajçak, duke pranuar se ish-sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Kofi Annan, dhe Ministri i Jashtëm rus, Sergey Lavrov, dikur kishin qenë modelet e tij profesionale.

“E ndryshova pikëpamjen time për Lavrovin pasi ai u bë fytyra dhe zëri i agresorit në Ukrainë”.

RËNDOHEN POZITAT PËR MANDELSON, I DËRGOI EPSTEIN TË DHËNA PËR QEVERINË BRITANIKE

Përfshirja e Lordit Peter Mandelson në skandalin Epstein mund të shkojë përtej pagesave të bëra nga financieri pedofil, përfshirë një të tillë në emër të Reinaldo Avila da Silva, partnerit të politikanit të njohur laburist në vitin 2009, sipas dokumenteve të publikuara nga Departamenti i Drejtësisë i SHBA-së.

Policia tani po shqyrton raportimet se Mandelson, ish sekretar shteti për Tregtinë dhe Industrinë, i ka përcjellë Epsteinin informacione të ndjeshme qeveritare, përfshirë paralajmërimin për paketën prej 500 miliardë eurosh të BE-së, e cila synonte shpëtimin e euros.

Tashmë, sipas BBC-së, politikani po shqyrtohet për shpërdorim të detyrës publike dhe sjellje e papërshtatshme financiare.

Ndërkohë, Keir Starmer përgatitet të drejtojë mbledhjen e tij javore të kabinetit me këtë zhvillim në fokus, pasi Zyra e Kryeministrit deklaroi se Mandelson nuk duhet të jetë anëtar i Dhomës së Lordëve.


Ky i fundit dha dorëheqjen nga Partia Laburiste të dielën në mbrëmje.

Ish-kryeministri Gordon Brown e dënoi rrjedhjen e dyshuar të një “dokumenti tepër sensitive qeveritar” gjatë krizës financiare, duke e cilësuar atë si “plotësisht të papranueshme”.

Starmer, sipas shtypit ndërkombëtar, gjithashtu i dha ultimatum sekretarit të përgjithshëm të qeverisë së tij Cris Wormald të shqyrtojë të gjitha informacionet në lidhje me kontaktet mes Mandelson dhe Epstein gjatë kohës së tij si ministër nga viti 2008 deri në vitin 2010.

Në një shkëmbim tjetër mesazhesh, të zbuluar nga Financial Times, Mandelson duket se sugjeron që Epstein t’i kërkojë kreut të JPMorgan të “ushtrojë presion” mbi kancelarin britanik për të ulur taksën mbi bonuset e bankierëve.





UEFA I PËRGJIGJET MINISTRIT ÇEKU: ÇDO KOMUNIKIM ZYRTAR KALON VETËM PËRMES FFK-së

PRISHTINË, 3 JANAR - UEFA i është përgjigjur zyrtarisht Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) dhe ministrit Hajrulla Çeku, duke konfirmuar pranimin e emailit të tyre. Në fund të muajit janar, ministri në detyrë i sportit, Çeku, u kishte shkruar letër UEFA-s dhe FIFA-s kinse për parregullsitë në FFK, lidhur me paralajmërimin e mbajtjes së Kuvendit Zgjedhor të 5 shkurtit. Sipas Çekut, një nga çështjet kryesore të ngritura ka të bëjë me standardet demokratike të kandidimit për president të FFK-së. "MKRS vë në pah se, megjithatë federata ka rreth 40 anëtarë, vetëm rreth 26 prej tyre janë të licencuar dhe me të drejtë vote, ndërsa Statuti vazhdon të kërkojë 15 nënshkrime mbështetëse për kandidim, çka sipas ministrisë, rezulton praktikisht në lejimin e

vetëm një kandidature dhe eliminimin e konkurrencës. MKRS rikujton se gjatë përgatitjes së Statutit të vitit 2023, kjo kërkesë ishte rekomanduar të hiqej nga grupet punuese të UEFA-s dhe FIFA-s, por megjithatë ka mbetur në versionin final të Statutit të FFK-së", thuhej në letrën drejtuar FIFA-s dhe UEFA-s. Në përgjigjen ndaj kësaj letrë të ministrisë, UEFA bën me dije se një letër nga FIFA dhe UEFA i është dërguar Federatës përkatëse (FFK), e cila është bashkëngjitur për referencë. UEFA i rikujton në mënyrë mjaft të qartë se çdo komunikim zyrtar kalon vetëm përmes FFK-së, së cilës i është dërguar paraprakisht letra e përbashkët e FIFA-s dhe UEFA-s. Kjo letër, e cila ka konfirmuar se FFK ka



bërë harmonizimin e statutit të saj me UEFA e FIFA, i është bashkëngjitur për referencë MKRS-së. UEFA, po ashtu, ka shprehur

gatishmërinë për diskutime të mëtejshme, nëse do të ketë nevojë, por vetëm pas kuvendit të 5 shkurtit, ku presidenti aktual Agim Ademi pritet të

konfirmohet për një tjetër mandat katërvjeçar. FFK-ja edhe këtë herë fiton përballë presionit mediatik e politik.

NGA SEMENYO TE PAQUETA DHE LOOKMAN, 10 TRANSFERIMET MË TË MËDHA TË JANARIT

PRISHTINË, 3 SHKURT - Afati kalimtar dimëror i vitit 2026 ka përfunduar në ligat kryesore dhe lista e "Transfermarkt" tregon se marrëveshjet më të mëdha janë përqendruar përsëri rreth Ligës Premierë. Transferimi më i shtrenjtë i dimrit është bërë nga Manchester City, i cili ka sjell Antoine Semenyo nga Bournemouth për 72 milionë euro. Ai pasohet nga një tjetër transferim i shtrenjtë që vjen në Ligën Premierë. Liverpooli ka sjellë qendërmbrojtësin Jeremy Jacquet për 63.6 milionë euro, i cili do të mbetet i huazuar te Rennes deri në fund të sezonit. Crystal Palace ishte ndër më aktivët në krye të listës. Ata kanë sjellë në klub sulmuesin Jorgen Strand Larsen nga Wolverhampton për 49.7 milionë euro, i ndjekur nga Brennan Johnson, i cili erdhi nga Tottenham Hotspuri për 40 milionë euro.



Dy transferime nga jashtë Evropës në 10 më të mirët

Tottenhami ka transferuar Conor Gallagherin nga Atletico Madridi për 40 milionë euro, ndërsa Atletico Madridi ka forcuar sulmin e tyre duke transferuar Ademola Lookmanin nga Atalanta për 35 milionë euro. I vetmi largim nga Liga Premierë në dhjetëshen e parë ishte



rikthimi i Lucas Paquetas në Brazil. Flamengo i ka paguar West Hamit 42 milionë euro për mesfushorin sulmues, një nga marrëveshjet më të mëdha të dimrit jashtë Anglisë. Në listë ka edhe dy nënshkrime të tjera të rëndësishme. Al-Hilali ka sjellë 18-vjeçarin Kader Meite nga Rennes për 30 milionë euro, ndërsa West Ham bleu Taty Castellanos nga Lazio për 29 milionë euro. Gjithashtu të spikatur në fund të 10 më të



mirëve janë Fulham, i cili ka sjellë Oscar Bobbo nga Manchester City për 31.2 milionë euro, si dhe Bournemouth, i cili e ka blerë sulmuesin Rayan nga Vasco da Gama për 28.5 milionë euro. Në përgjithësi, ky dimër ka treguar se klubet angleze vazhdojnë ta diktojnë ritmin e tregut, dhe se edhe "shtresa e mesme" e Ligës Premierë po hyn gjithnjë e më shumë në transferime që deri vonë ishin të rezervuara vetëm për gjigantët e elitës.

10 transferimet më të shtrenjta të janarit 2026:

- Antoine Semenyo (nga Bournemouth te Manchester City) - 72 milionë euro
- Jeremy Jacquet (nga Rennes te Liverpool) - 63.6 milionë euro
- Jorgen Strand Larsen (nga Wolves te Crystal Palace) - 49.7 milionë euro
- Lucas Paqueta (nga West Ham te Flamengo) - 42 milionë euro
- Conor Gallagher (nga Atletico Madrid te Tottenham) - 40 milionë euro
- Brennan Johnson (nga Tottenham te Crystal Palace) - 40 milionë euro
- Ademola Lookman (nga Atalanta te Atletico) - 35 milionë euro
- Oscar Bobb (nga Manchester City te Fulham) - 31.2 milionë euro
- Kader Meite (nga Rennes te Al-Hilal) - 30 milionë euro
- Rayan (nga Vasco da Gama te Bournemouth) - 28.5 milionë euro

Rei Manaj zyrtarizohet te Sivasspori

Sivas, 3 shkurt - Skuadra e kategorisë së dytë të Turqisë, Sivasspori, e ka zyrtarizuar transferimin e sulmuesit shqiptar, Rey Manaj. Manaj kthehet te Sivasspori pas aventurës që ka kaluar te skuadra Al-Sharjah në Emiratet

e Bashkuara Arabe. Manaj pikërisht nga Sivasspori i ishte bashkuar Al-Sharjahut verën e kaluar për 2 milionë euro dhe sulmuesi ka vendosur që sërish t'i bashkohet ekipit turk, me të cilin ka nënshkruar kontratë për tri vjet e gjysmë.

Manaj ishte pjesë e Sivassporit për dy sezone, periudhë kjo gjatë së cilës ka zhvilluar 63 ndeshje dhe ka kontribuar me 34 gola dhe tetë asistime. 28-vjeçari me ekipin Al-Sharjah në pjesën e parë të këtij sezoni ka realizuar gjashtë gola në 21 paraqitje,

ndërsa në të kaluarën ka luajtur edhe për skuadra si Watford, Inter, Cremonese, Albacete dhe AC Pisa. Ndërkohë, me Kombëtaren e Shqipërisë, Manaj ka 10 gola të shënuar në 44 ndeshje të luajtura deri më tani.





UEFA I PËRGJIGJET MINISTRIT ÇEKU: ÇDO KOMUNIKIM ZYRTAR KALON VETËM PËRMES FFK-së

PRISHTINË, 3 JANAR - UEFA i është përgjigjur zyrtarisht Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) dhe ministrit Hajrulla Çeku, duke konfirmuar pranimin e emailit të tyre. Në fund të muajit janar, ministri në detyrë i sportit, Çeku, u kishte shkruar letër UEFA-s dhe FIFA-s kinse për parregullsitë në FFK, lidhur me paralajmërimin e mbajtjes së Kuvendit Zgjedhor të 5 shkurtit. Sipas Çekut, një nga çështjet kryesore të ngritura ka të bëjë me standardet demokratike të kandidimit për president të FFK-së. "MKRS vë në pah se, megjithatë federata ka rreth 40 anëtarë, vetëm rreth 26 prej tyre janë të licencuar dhe me të drejtë vote, ndërsa Statuti vazhdon të kërkojë 15 nënshkrime mbështetëse për kandidim, çka sipas ministrisë, rezultojnë praktikisht në lejimin e

vetëm një kandidature dhe eliminimin e konkurrencës. MKRS rikujton se gjatë përgatitjes së Statutit të vitit 2023, kjo kërkesë ishte rekomanduar të hiqej nga grupet punuese të UEFA-s dhe FIFA-s, por megjithatë ka mbetur në versionin final të Statutit të FFK-së", thuhej në letrën drejtuar FIFA-s dhe UEFA-s. Në përgjigjen ndaj kësaj letrë të ministrisë, UEFA bën me dije se një letër nga FIFA dhe UEFA i është dërguar Federatës përkatëse (FFK), e cila është bashkëngjitur për referencë. UEFA i rikujton në mënyrë mjaft të qartë se çdo komunikim zyrtar kalon vetëm përmes FFK-së, së cilës i është dërguar paraprakisht letra e përbashkët e FIFA-s dhe UEFA-s. Kjo letër, e cila ka konfirmuar se FFK ka



bërë harmonizimin e statutit të saj me UEFA e FIFA, i është bashkëngjitur për referencë MKRS-së. UEFA, po ashtu, ka shprehur

gatishmërinë për diskutime të mëtejshme, nëse do të ketë nevojë, por vetëm pas kuvendit të 5 shkurtit, ku presidenti aktual Agim Ademi pritet të

konfirmohet për një tjetër mandat katërvjeçar. FFK-ja edhe këtë herë fiton përballë presionit mediatik e politik.

NGA SEMENYO TE PAQUETA DHE LOOKMAN, 10 TRANSFERIMET MË TË MËDHA TË JANARIT

PRISHTINË, 3 SHKURT - Afati kalimtar dimëror i vitit 2026 ka përfunduar në ligat kryesore dhe lista e "Transfermarkt" tregon se marrëveshjet më të mëdha janë përqendruar përsëri rreth Ligës Premierë. Transferimi më i shtrenjtë i dimrit është bërë nga Manchester City, i cili ka sjellë Antoine Semenyo nga Bournemouth për 72 milionë euro. Ai pasohet nga një tjetër transferim i shtrenjtë që vjen në Ligën Premierë. Liverpooli ka sjellë qendërmbrojtësin Jeremy Jacquet për 63.6 milionë euro, i cili do të mbetet i huazuar te Rennes deri në fund të sezonit. Crystal Palace ishte ndër më aktivët në krye të listës. Ata kanë sjellë në klub sulmuesin Jorgen Strand Larsen nga Wolverhampton për 49.7 milionë euro, i ndjekur nga Brennan Johnson, i cili erdhi nga Tottenham Hotspuri për 40 milionë euro.



Dy transferime nga jashtë Evropës në 10 më të mirët

Tottenhami ka transferuar Conor Gallagherin nga Atletico Madridi për 40 milionë euro, ndërsa Atletico Madridi ka forcuar sulmin e tyre duke transferuar Ademola Lookmanin nga Atalanta për 35 milionë euro. I vetmi largim nga Liga Premierë në dhjetëshen e parë ishte



rikthimi i Lucas Paquetas në Brazil. Flamengo i ka paguar West Hamit 42 milionë euro për mesfushorin sulmues, një nga marrëveshjet më të mëdha të dimrit jashtë Anglisë. Në listë ka edhe dy nënshkrime të tjera të rëndësishme. Al-Hilali ka sjellë 18-vjeçarin Kader Meite nga Rennes për 30 milionë euro, ndërsa West Ham bleu Taty Castellanos nga Lazio për 29 milionë euro. Gjithashtu të spikatur në fund të 10 më të



mirëve janë Fulham, i cili ka sjellë Oscar Bobbo nga Manchester City për 31.2 milionë euro, si dhe Bournemouth, i cili e ka blerë sulmuesin Rayan nga Vasco da Gama për 28.5 milionë euro. Në përgjithësi, ky dimër ka treguar se klubet angleze vazhdojnë ta diktojnë ritmin e tregut, dhe se edhe "shtresa e mesme" e Ligës Premierë po hyn gjithnjë e më shumë në transferime që deri vonë ishin të rezervuara vetëm për gjigantët e elitës.

10 transferimet më të shtrenjta të janarit 2026:

- Antoine Semenyo (nga Bournemouth te Manchester City) - 72 milionë euro
- Jeremy Jacquet (nga Rennes te Liverpool) - 63.6 milionë euro
- Jorgen Strand Larsen (nga Wolves te Crystal Palace) - 49.7 milionë euro
- Lucas Paqueta (nga West Ham te Flamengo) - 42 milionë euro
- Conor Gallagher (nga Atletico Madrid te Tottenham) - 40 milionë euro
- Brennan Johnson (nga Tottenham te Crystal Palace) - 40 milionë euro
- Ademola Lookman (nga Atalanta te Atletico) - 35 milionë euro
- Oscar Bobb (nga Manchester City te Fulham) - 31.2 milionë euro
- Kader Meite (nga Rennes te Al-Hilal) - 30 milionë euro
- Rayan (nga Vasco da Gama te Bournemouth) - 28.5 milionë euro

Rei Manaj zyrtarizohet te Sivasspori

Sivas, 3 shkurt - Skuadra e kategorisë së dytë të Turqisë, Sivasspori, e ka zyrtarizuar transferimin e sulmuesit shqiptar, Rey Manaj. Manaj kthehet te Sivasspori pas aventurës që ka kaluar te skuadra Al-Sharjah në Emiratet

e Bashkuara Arabe. Manaj pikërisht nga Sivasspori i ishte bashkuar Al-Sharjahut verën e kaluar për 2 milionë euro dhe sulmuesi ka vendosur që sërish t'i bashkohet ekipit turk, me të cilin ka nënshkruar kontratë për tri vjet e gjysmë.

Manaj ishte pjesë e Sivassporit për dy sezone, periudhë kjo gjatë së cilës ka zhvilluar 63 ndeshje dhe ka kontribuar me 34 gola dhe tetë asistime. 28-vjeçari me ekipin Al-Sharjah në pjesën e parë të këtij sezoni ka realizuar gjashtë gola në 21 paraqitje,

ndërsa në të kaluarën ka luajtur edhe për skuadra si Watford, Inter, Cremonese, Albacete dhe AC Pisa. Ndërkohë, me Kombëtaren e Shqipërisë, Manaj ka 10 gola të shënuar në 44 ndeshje të luajtura deri më tani.



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Andi 02” SH.P.K. me seli në Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812266858 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Andi 02” D.O.O. Mitrovica donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812266858 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Andi 02” L.L.C. with headquarters Mitrovica, has come to the decision to quit its business: 812266858 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Akademia e Teknologjisë dhe Digitalizimit” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812256544 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Akademia e Teknologjisë dhe Digitalizimit” D.O.O. Prishtina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812256544 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Akademia e Teknologjisë dhe Digitalizimit” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 812256544 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Zahrije Makshana shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Vëllezërit Frashëri” Drenovc Rahovec nga kl. 1-5 dhe 6-9.

- Rexhep Rexhepishpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Zenel Sadiku” Babaj Bokes Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.

- Beqir Deva shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike “Nexhmedin Nixha” Automekanik në Gjakovë.

- Dafina Gashi shpall të pavlefshme dëftesat e vitit XI , XII shme “ Ymer Prizreni” Prizren.

- Nazmi Krasniqi shpall të pavlefshme certifikatën QK “11 Marsi” Prizren.

- Mesude Dogani shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu “Mati Logoreci” Prizren.

“FAR” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810155722.

- Fitore Rexhepi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Fazli Greçevci”.

- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjmnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjmnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

NJOFTIM MBI ZVOGLIMIN E KAPITALIT TË
SHOQËRISË
"Beverly Park Residences " LLC
NUI: 812035568

Në përputhje me kërkesat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare në Kosovë dhe të Marreveshjes dhe Statutit se Shoqërisë, të plotësuar dhe ndryshuara, Aksionari i shoqërisë “Beverly Park Residences” L.L.C. me seli në Fushë Kosovë, rruga Rruga Miradi e Epërme, Parcela 508-2, me numër unik identifikues 812035568 (“Shoqëria”) ka nxjerr:

VENDIM PËR ZVOGLIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË me datë 03.02.2026

Kapitali i shoqërisë zvogëlohet në vlerën prej 990,000.00 EURO përmes paluajtshmerisë në zonën kadastrale Preoc, Gracanice, përkatësisht kapitali zvogëlohet nga vlera e regjistruar **3,293,000.00 Euro** në **2,303,000.00 Euro**

Të gjithë Kreditorët e Shoqërisë kanë të drejtën që në afatin 21 ditor nga dita e publikimit të këtij njoftimi në shtypin ditor të drejtohen Shoqërisë me kërkesë për siguri shtesë ose kërkesë për mos-zvoglim të kapitalit. Kërkesat i drejtohen Shoqërisë përmes postës së rregullt në adresën:

“Beverly Park Residences” L.L.C. me seli në Fushë Kosovë, rruga Rruga Miradi e Epërme, Parcela 508-2.



MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

